



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 11335 prot

Vlorë, 23.12.2019

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 290 datë 23.12 2019

“PËR AUTORIZIMIN E FIRMËS SË KRYETARIT TË BASHKISË”

Në zbatim të ligjit Nr. 139.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika b neni 64 pika a,b dhe ligjit nr. 44/20015, date 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 22, neni 23.

URDHEROJ

1. Autorizohet Z. Jeton Puka, që gjatë mungesës së Kryetarit të Bashkisë Vlorë të nënshkruajë si më poshtë:

- Delegimin e shkresave që kanë ardhur/hyrë në Bashkinë Vlorë nga institucionet publike, private, apo nga marrëdhëniet me publikun.
- Nënshkrimin e shkresave, përmbajtja e të cilave nuk është e lidhur ngushtë me detyrën e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, vërtetime të ndryshme, kthim përgjigje.
- Nënshkrimin e shkresave apo kryerjen e veprimeve ligjore, për të cilat autorizohet elektronikisht nga Kryetari i Bashkisë.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Z. Jeton Puka dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

3. Ky urdhër do të publikohet menjëherë në faqen zyrtare të Bashkisë Vlore, për efekt të njoftimit të personave të interesuar



KRYETAR

Dritan LELI